

V E N D I M
Nr. 429, datë 11.6.2001

PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË GJYQËSORE

(Ndryshuar me VKM nr.309, datë 27.6.2002)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pagat mujore të punonjësve të Policisë Gjyqësore në Ministrinë e Rendit Publik, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve dhe Prokurorinë e Përgjithshme, janë si më poshtë vijnë:

- *Oficer i policisë gjyqësore në Tiranë 44 000 lekë*

- *Oficer i policisë gjyqësore 43 750 lekë.*

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2001, miratuar për institucionet e mësipërme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2001.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta